



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 8

2002

Prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8866 datë 14.3.2002	Për ratifikimin e “Traktatit të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës”..	185
Ligj nr.8867 datë 14.3.2002	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Statutin e Konferencës së Hagës për të drejtën ndërkombëtare private”....	189
Vendim i Kuvendit nr.19, datë 28.2.2002	Për mosmiratimin e raportit vjetor 2001 të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT)	192
Vendim i Kuvendit nr.20, datë 18.3.2002	Mbi propozimin për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë	193
Vendim i Kuvendit nr.21, datë 29.3.2002	Për mosmiratimin e dekretit nr.3061, datë 14.6.2001 “Për kthimin e ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”	193
Vendim i Kuvendit nr.22, datë 29.3.2002	Mbi dhënien e pëlqimit për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm	194

Akt normativ nr.1, datë 4.4 2002	Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjet përkatëse	194
Akt normativ nr.2, datë 4.4 2002	Për një ndryshim në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ndryshuar me ligjet përkatëse	195
Akt normativ nr.3, datë 4.4 2002	Për një ndryshim në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me ligjet përkatëse	195
Akt normativ nr.4, datë 4.4 2002	Për një ndryshim në ligjin 8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”	196
Vendim i Gj.K nr. 28, datë 21.2.2002	Me objekt interpretimin e neneve 96 e 97 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe pezullimin e procedurave të shqyrtimit të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij.....	196

LIGJ
Nr. 8866, datë 14.3.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “TRAKTATIT TË MIQËSISË DHE BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Traktati i miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës”, nënshkruar në Tiranë më 22.11.2001.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3273, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

TRAKTATI
**I MIQËSISË DHE BASHKËPUNIMIT MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MBRETËRISË SË SPANJËS**

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës, të quajtura më poshtë Palë Kontraktuese:
Të frymëzuara nga ndjenja të thella miqësie dhe respekti të ndërsjellë midis dy popujve,
Të angazhuara vendosmërisht në detyrën për të kontribuar në vendosjen e një rendi
ndërkombëtar më të drejtë, human, paqësor dhe demokratik,

Të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tyre për ruajtjen e paqes në Europë dhe në botë dhe të
vendosura të zbatojnë qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara,

Dhe

Duke ritheksuar besnikërinë e tyre ndaj angazhimeve që rrjedhin nga e drejta
ndërkombëtare,

Duke njohur rëndësinë e angazhimeve të marra përsipër nga Akti Përfundimtar i Helsinkit,
Karta e Parisit për një Europë të Re dhe dokumenteve pasuese të OSBE-së,

Duke ritheksuar rëndësinë e zhvillimit të bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe
Bashkimit Europian,

Janë marrë vesh sa më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mënyrë aktive në të gjitha sferat në bazë të
respektit dhe të mirëbesimit të ndërsjellë, në përputhje me parimet dhe vlerat demokratike të cilave u
përmbahen të dy Palët dhe do të kontribuojnë në mënyrë aktive për afrimin e popujve të tyre në
kuadrin e një Europe të Bashkuar.

Neni 2

Në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, të Akteve Përfundimtare të Helsinkit dhe të Kartës së Parisit për një Europë të Re, Palët Kontraktuese do të zhvillojnë marrëdhëniet dypalëshe si Shtete miq, të udhëhequr nga parimet e barazisë sovrane, tërësisë territoriale, padhunueshmërisë së kufijve, pavarësisë politike të Shteteve, mospërdorimit ose kërcënimit të forcës, rregullimit të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare me mjete paqësore, barazisë së të drejtave dhe të vetvendosjes së lirë të popujve, respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, bashkëpunimit midis Shteteve dhe përmbushjes me besnikëri të detyrimeve të marra përsipër sipas së drejtës ndërkombëtare.

Neni 3

Në kuadrin e procesit të Organizatës së Sigurimit dhe Bashkëpunimit në Europë, Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës do të kontribuojnë në forcimin e përgjithshëm të demokracisë, pluralizmit politik, të shtetit të së drejtës dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Të dy Palët do të vendosin një bashkëpunim të ngushtë në fushat që kanë rëndësi nga pikpamja e procesit të integritetit evropian.

Gjithashtu, Mbretëria e Spanjës do të mbështesë përpjekjet e Republikës së Shqipërisë për të zhvilluar një bashkëpunim më të ngushtë me Bashkimin Evropian.

Neni 4

Në kuadrin e Organizatës së Sigurimit dhe Bashkëpunimit në Europë, Palët Kontraktuese do të punojnë për të forcuar stabilitetin në kontinentin evropian, duke marrë parasysh interesat e secilës prej tyre në sferën e sigurimit. Gjithashtu do të punojnë për realizimin e një procesi të ekuilibruar të çarmatimit konvencional dhe përmirësimit të mirëbesimit dhe të transparencës, duke u bazuar në zbatimin efektiv për të gjitha Shtetet të parimit të mbrojtjes së mjaftueshme, duke marrë parasysh edhe tërësinë e kushteve të sigurimit në Europë.

Palët Kontraktuese do të kontribuojnë për vendosjen dhe funksionimin më të mirë të strukturave dhe të mekanizmave institucionale, të përshtatshme për të forcuar efikasitetin e procesit të Organizatës së Sigurimit dhe të Bashkëpunimit në Europë.

Neni 5

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë konsultime të rregullta në nivele të ndryshme, me qëllim që të lehtësojnë zhvillimin e marrëdhënieve të tyre dypalëshe dhe të harmonizojnë brenda mundësive pozitat e tyre në çështjet ndërkombëtare me interes të përbashkët.

Takimet e nivelit të lartë politik do të bëhen gjithmonë kur të shihet e nevojshme.

Ministrat e Punëve të Jashtme do të takohen të paktën një herë në vit.

Takimet midis anëtarëve të tjerë të të dy Qeverive do të zhvillohen gjithmonë kur të shihet e nevojshme.

Konsultimet periodike në nivel ekspertësh do të zhvillohen rregullisht.

Neni 6

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë dhe do të thellojnë marrëdhëniet e tyre në fushën e mbrojtjes.

Neni 7

Në rast se krijohen situata që, sipas gjykimit të njërës nga të dy Palët, krijojnë rrezik për paqen dhe sigurinë, duke ngritur kështu tensionin ndërkombëtar, Qeveritë e Republikës së Shqipërisë dhe të Mbretërisë së Spanjës do të vihen urgjentisht në kontakt me kanalet që konsiderohen të përshtatshme me qëllim që të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre lidhur me veprimet që mund të ndërmerren për të lehtësuar tensionin dhe për të zgjidhur problemet e krijuara nga kjo gjendje.

Në qoftë se njëra nga Palët Kontraktuese mendon se janë prekur interesat e sigurimit të saj, mund t'i propozojë Palës tjetër që të zhvillojë menjëherë konsultime dypalëshe.

Neni 8

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë bashkëpunimin ekonomik dypalësh dhe do të krijojnë kushte të favorshme për të, duke theksuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi, si dhe për suksesin e reformave ekonomike në Republikën e Shqipërisë, ashtu edhe për afrimin e saj gradual me strukturat europiane.

Secila Palë angazhohet, në kuadrin e legjislacionit të saj kombëtar dhe të marrëveshjeve dypalëshe përkatëse, të krijojë kushte të favorshme për të nxitur në territorin e saj investimet e Palës tjetër, duke siguruar mbrojtjen e tyre, me qëllim që të përmirësohen kushtet e veprimtarisë së ndërmarrjeve të Palës tjetër në territorin e saj.

Me qëllim që të krijohen kushte të favorshme për realizimin e iniciativave dhe projekteve të përbashkëta, Palët do të nxisin lidhjet e drejtpërdrejta midis ndërmarrjeve spanjolle dhe shqiptare dhe modalitetet e reja të bashkëpunimit ekonomik, sidomos në fushën e investimeve e të ndërmarrjeve të përbashkëta.

Palët Kontraktuese do të nxisin shkëmbimin e informacionit ekonomik dhe shfrytëzimin e tij nga ekspertët e të dy vendeve, si edhe zhvillimin e bashkëpunimit midis organizatave e shoqatave të ndërmarrjeve të të dy vendeve.

Për të lehtësuar kalimin në ekonominë e tregut në Republikën e Shqipërisë, Mbretëria e Spanjës do të sigurojë bashkëpunimin e saj me ndihmë teknike dhe me formimin e specialistëve dhe të kuadrove drejtues në këtë fushë.

Neni 9

Palët Kontraktuese angazhohen të zhvillojnë bashkëpunimin në fushat e bujqësisë, industrisë, infrastrukturave dhe ndërtimit, transportit dhe telekomunikacioneve, shërbimeve dhe turizmit.

Neni 10

Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, Palët Kontraktuese do të përpiqen të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në këtë fushë si në rrafshin dypalësh, ashtu edhe në atë shumëpalësh, sidomos në shkallë europiane.

Neni 11

Palët Kontraktuese, të frymëzuara nga dëshira për të bashkëpunuar për një shkëmbim sa më të plotë të vlerave artistike për krijimin e një hapësire kulturore europiane, do të zhvillojnë sa më shumë bashkëpunimin kulturor, shkencor dhe arsimor midis tyre.

Palët njohin rëndësinë e veçantë të mësimin të gjuhëve si kusht i domosdoshëm për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe për njohjen e ndërsjellë të kulturës së popujve. Secila Palë do të nxisë në territorin e saj mësimin e gjuhëve dhe të letërsisë të Palës tjetër.

Të dy Palët do të mbështesin bashkëpunimin e drejtëpërdrejtë dhe shkëmbimin midis institucioneve publike, universiteteve dhe organizmave të tjera të arsimit të lartë, qendrave të kërkimeve shkencore, organizatave dhe personave privatë, në fushën e kulturës, të shkencës dhe të arsimit dhe do të bashkëpunojnë në realizimin e projekteve shkencore të përbashkëta.

Palët Kontraktuese i kushtojnë një rëndësi të madhe krijimit dhe zhvillimit të aktivitetit të qendrave kulturore që mund t'i dedikohen mësimit dhe përhapjes së gjuhëve dhe kulturave të vendeve të tyre respektive.

Do të ofrohet ndihmë e veçantë në formimin e profesorëve dhe do të vendosen mjetet e nevojshme për shfrytëzimin e materialeve didaktike, literaturës së specializuar dhe për përdorimin e teknikave audiovizuale dhe të informatikës.

Secila prej Palëve do të nxisë bashkëpunimin në fushën e mjeteve të komunikimit masiv dhe të shpërndarjes së shtypit të shkruar të Palës tjetër.

Neni 12

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë dhe do të lehtësojnë bashkëpunimin në fushat e shëndetësisë, të asistencës sociale, edukimit fizik, sportit dhe të turizmit, si edhe zhvillimin e shkëmbimeve rinore.

Neni 13

Palët Kontraktuese do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë thellimit të marrëdhënieve midis Parlamenteve të Shqipërisë dhe të Spanjës.

Duke marrë parasysh sistemet kushtetuese të të dy shteteve, Palët do të mbështesin kontaktet e drejtëpërdrejta dhe bashkëpunimin midis autoriteteve krahinore dhe lokale.

Në të njëjtën frymë, Palët do të lehtësojnë bashkëpunimin midis organizatave politike, shoqërore dhe sindikale të të dy vendeve.

Neni 14

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë bashkëpunimin në fushën juridike ndërkombëtare, në përputhje me konventat ndërkombëtare, ekzistuese.

Neni 15

Palët do të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut të paligjshëm të narkotikëve ndërmjet shkëmbimit të përvojës dhe të informacionit operativ midis organeve të tyre kompetente.

Palët angazhohen gjithashtu të bashkëpunojnë në luftën kundër terrorizmit, sekuestrimit të mjeteve të transportit detar, ajror dhe kontrabandës, duke përfshirë importimin, eksportimin dhe transferimin e pronës së paligjshme të vlerave kulturore.

Neni 16

Kushtet e këtij Traktati nuk prekin të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe të përfunduara nga Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës me Shtete të Treta.

Neni 17

Ky Traktat do të ratifikohet nga secila Palë dhe do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas shkëmbimit të Instrumenteve përkatëse të Ratifikimit.

Ky Traktat ka fuqi për dhjetë vjet, të përsëritshme në mënyrë të heshtur në periudha pesëvjeçare. Kur njëra Palë dëshiron të denoncojë Traktatin, duhet ta njoftojë Palën tjetër me shkrim dhe me rrugë diplomatike një vit para skadimit të secilës periudhë të fuqisë së Traktatit.

Bërë në Tiranë, më 22 nëntor 2001 në dy kopje, të redaktuara në shqip dhe spanjisht, duke qenë të dy tekstet njëloj të vlefshëm.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Mbretërinë e Spanjës

LIGJ

Nr. 8867, datë 14.3.2002

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “STATUTIN E KONFERENCËS SË HAGËS PËR TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Statutin e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3274, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

STATUTI

I KONFERENCËS SË HAGËS MBI TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE

Hartuar në sesionin e 17-të, të zhvilluar në Hagë nga 3-31 tetor 1951

Qeveritë e vendeve të Republikës Federale të Gjermanisë, Austrisë, Belgjikës, Danimarkës, Spanjës, Finlandës, Francës, Italisë, Japonisë, Luksemburgut, Norvegjisë, Holandës, Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës Veriore, Suedisë dhe Zvicrës;

Në vijim të karakterit të përhershëm të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private;

Duke dëshiruar të vazhdojnë këtë karakter;

Duke shprehur, si përfundim, dëshirën për ta pajisur Konferencën me një statut;

Kanë rënë dakord për nenet e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi i Konferencës së Hagës është të punojë për njehsimin progresiv të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Neni 2

Anëtarët e Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private janë Shtetet, të cilat kanë marrë pjesë tashmë në një ose më shumë sesione të Konferencës dhe që kanë pranuar Kartën ekzistuese.

Çdo shtet, pjesëmarrja e të cilit, nga pikëpamja juridike, është e rëndësishme për veprimtarinë e Konferencës, mund të bëhet anëtar. Pranimi i anëtarëve të rinj do të vendoset nga Qeveritë e Shteteve pjesëmarrëse, nëpërmjet propozimit të njërit, ose disa prej tyre, me anë të një shumice votash, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur ky propozim iu është paraqitur Qeverive.

Pranimi do të bëhet përfundimtar nëpërmjet pranimit të statutit nga shteti i interesuar.

Neni 3

Komisioni i Përhershëm i Qeverisë së Holandës, i krijuar me Dekretin Mbretëror të 20 shkurtit 1987, me qëllim nxitjen e kodifikimit të së drejtës ndërkombëtare private, është i ngarkuar me detyrën e kryerjes së veprimeve të Konferencës.

Ky Komitet vepron nëpërmjet Zyrës së Përhershme për të ushtruar aktivitetin me të cilin është ngarkuar.

Ai do të kontrollojë të gjitha propozimet që kanë synim vendosjen në rendin e ditës së Konferencës. Ky Komitet do të jetë i lirë të përcaktojë veprimet që do të ndërmerren lidhur me këto propozime.

Komiteti i Përhershëm Qeveritar, pas konsultimeve me anëtarët e Konferencës, do të përcaktojë datën dhe rendin e ditës së sesionit.

Ai do t'i drejtohet vetë Qeverisë së Holandës për thirrjen e anëtarëve.

Sesioni i zakonshëm i Konferencës, parimisht, do të mbahet çdo katër vjet.

Nëse është e nevojshme, Komiteti i Përhershëm Qeveritar, me aprovimin e anëtarëve, mund t'i kërkojë Qeverisë së Holandës të thërrasë Konferencën në sesione të jashtëzakonshme.

Neni 4

Zyra e Përhershme do të ketë selinë e saj në Hagë. Ajo do të përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe dy Sekretarë të shtetësive të ndryshme, të cilët do të caktohen nga Qeveria e Holandës nëpërmjet prezantimit të Komitetit të Përhershëm Qeveritar.

Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretarët duhet të zotërojnë njohuri ligjore të përshtatshme dhe eksperiencë praktike.

Numri i Sekretarëve mund të rritet pas konsultimeve me anëtarët e Konferencës.

Neni 5

Sipas udhëzimeve të Komitetit të Përhershëm Qeveritar, Zyra e Përhershme është e ngarkuar me:

a) përgatitjen dhe organizimin e sesionit të Konferencës së Hagës dhe takimet e komisionit special;

b) punën e Sekretariatit të sesionit dhe takimet e pasqyruara më sipër;

c) të gjitha detyrat që janë të përfshira në aktivitetin e një sekretariati.

Neni 6

Me qëllim për të lehtësuar komunikimin ndërmjet anëtarëve të Konferencës dhe Zyrës së Përhershme, Qeveria e çdo Shteti Anëtar do të krijojë një zyrë kombëtare.

Zyra e Përhershme mund të komunikojë me të gjitha zyrat kombëtare të krijuara dhe me degët e organizatave ndërkombëtare.

Neni 7

Konferenca dhe Komiteti i Përhershëm Qeveritar, në intervalet ndërmjet sesioneve, mund të përgatisë projekte konventash ose të shqyrtojë të gjitha çështjet e së drejtës ndërkombëtare private që shfaqen, në përputhje me qëllimin e Konferencës.

Neni 8

Shpenzimet e veprimtarisë dhe mbajtjes së Zyrës së Përhershme dhe komiteteve speciale do të pjestohen mes anëtarëve të Konferencës me përjashtim të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës së delegatëve të komiteteve speciale që do të mbulohen nga qeveritë e përfaqësuara.

Neni 9

Buxheti i Zyrës së Përhershme dhe Komiteteve Speciale do t'i paraqitet çdo vit përfaqësuesve diplomatikë të Shteteve Anëtare në Hagë për aprovim.

Këta përfaqësues do të përpjestojnë, midis anëtarëve, shpenzimet që janë përcaktuar në këtë buxhet për të ardhmen.

Përfaqësues diplomatikë do të takohen për këto çështje nën drejtimin e Ministrit të Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 10

Shpenzimet që rezultojnë nga sesioni i rregullt i Konferencës do të mbulohen nga Qeveria e Holandës.

Në rastin e sesioneve speciale, shpenzimet do të ndahen midis anëtarëve të Konferencës që janë përfaqësuar në këtë sesion.

Në të gjitha rastet, shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimit të delegatëve do të mbulohen nga Qeveritë e tyre respektive.

Neni 11

Veprimtaria e Konferencës do të vazhdojë të vëzhgohet nga të gjitha pikëpamjet, me përjashtim kur kjo është në kundërshtim me këtë statut ose me rregulloret.

Neni 12

Këtij Statuti mund t'i bëhen amendamente nëse aprovohen nga dy të tretat e anëtarëve.

Neni 13

Parashikimet e kësaj Karte, në mënyrë që të bëhen të zbatueshme, duhet të plotësohen me rregulloret.

Rregulloret do të përcaktohen nga Zyra e Përhershme dhe do t'u paraqiten Qeverive anëtare për aprovim.

Neni 14

Ky Statut do t'u paraqitet Qeverive të Shteteve, që marrin pjesë në një ose më shumë sesione të Konferencës. Ai do të hyjë në fuqi sapo të pranohet nga shumica e Shteteve të interesuara në sesionin e shtatëmbëdhjetë.

Akti i pranimit do të depozitohet pranë Qeverisë së Holandës, e cila do t'ua bëjë të njohur Qeverive që përmenden në paragrafin e parë të këtij neni. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet në rastin e pranimit të një Shteti të ri, në bazë të aktit të pranimit të këtij shteti.

Neni 15

Çdo Shtet Anëtar mund të denoncojë këtë Statut pas një periudhe prej pesë vjetësh, pas hyrjes së tij në fuqi, sipas përmbajtjes së nenit 14 paragrafi 1.

Njoftimi i denoncimit do t'i jepet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, të paktën gjashtë muaj para mbarimit të vitit buxhetor të Konferencës dhe do të veprojë në fund të këtij viti, por vetëm për atë Shtet, i cili ka njoftuar për një gjë të tillë.

VENDIM

Nr. 19, datë 28.2.2002

PËR MOSMIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR 2001 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIO DHE TELEVISIONIT (KKRT)

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Mosmiratimin e Raportit Vjetor 2001 për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Namik Dokle**

VENDIM
Nr. 20, datë 18.3.2002

**MBI PROPOZIMIN PËR SHKARKIMIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 149 paragrafi 2 të Kushtetutës dhe të neneve 88, 92,157 e 158 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. T'i propozojë Presidentit të Republikës shkarkimin e zotit Arben Rakipi nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë për akte e sjellje që kanë diskredituar rëndë pozitën e Prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Namik Dokle

VENDIM
Nr. 21, datë 29.3.2002

**PËR MOSMIRATIMIN E DEKRETIT NR.3061, DATË 14.6.2001 "PËR KTHIMIN E LIGJIT
NR.8811, DATË 17.5.2001 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË
LARTË TË DREJTËSISË"**

Në mbështetje të nenit 85 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Të mos miratohet dekreti nr.3061, datë 14.6.2001 "Për kthimin e ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Namik Dokle

VENDIM
Nr. 22, datë 29.3.2002

MBI DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të neneve 78 dhe 149 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, me kërkesë të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

1. Jep pëlqimin për emërimin e zotit Theodhori Sollaku në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Namik Dokle

AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 4.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 “PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT”, NDRYSHUAR ME LIGJET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjet përkatëse, fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit”, zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

**AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 4.4.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8306, DATË 14.3.1998 “PËR STRATEGJINË E
PRIVATIZIMIT TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË”, NDRYSHUAR ME
LIGJET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ndryshuar me ligjet përkatëse, fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**

**AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 4.4.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7926, DATË 20.4.1995 “PËR TRANSFORMIMIN E
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE”, NDRYSHUAR ME
LIGJET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me ligjet përkatëse, fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**

AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 4.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8334, DATË 23.4.1998 “PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”.

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë“

Neni 2

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 28, datë 21.2.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Gjergj Sauli,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Tefta Zaka,	Anëtare e ““
Petrit Ploçi,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21.2.2002, në seancë plenare, mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, mori në shqyrtim çështjen nr.46 Akti që i përket:

KËRKUES: Një grup prej 29 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë
SUBJEKT I INTERESUAR:

1. Kuvendi i Shqipërisë
2. Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Interpretimi i neneve 96 e 97 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si dhe pezullimi i procedurave të shqyrtimit të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1-c dhe 124/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Një grup prej 29 Deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, kanë kërkuar interpretimin e neneve 96 e 97 të Kushtetutës për miratimin e Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij, duke pretenduar se diskutimi e miratimi i përbërjes dhe programit të qeverisë nuk mund të bëhet pa miratuar më parë në Kuvend Kryeministrin e emëruar nga Presidenti.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Kujtim Puto, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Një grup prej 29 deputetësh, që përbëjnë më shumë se 1/5 e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, i kanë kërkuar Gjykatës Kushtetuese interpretimin e neneve 96 e 97 të Kushtetutës, të cilat parashikojnë procedurën e miratimit të Kryeministrit, të përbërjes dhe të programit politik të Këshillit të Ministrave. Ata kanë kërkuar, gjithashtu, pezullimin e zbatimit të kësaj procedure deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga kjo Gjykatë.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e datës 20.2.2002 konstatoi se Kuvendi në seancë plenare, sipas neneve 96 e 97 të Kushtetutës, e kishte filluar procedurën për miratimin e Kryeministrit, së bashku me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Pas diskutimit të kërkesës për pezullim, Mbledhja e Gjyqtarëve arriti në konkluzionin se përfundimi nga Kuvendi i procedurës për miratimin e Kryeministrit, të programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave përpara shpalljes së vendimit përfundimtar nga kjo Gjykatë për interpretimin e normave të mësipërme të Kushtetutës, mund të sillte pasoja që preknin interesat shtetërore. Prandaj, në kuptim të neneve 1 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe të dispozitave procedurale që parashikojnë marrjen e masave për pezullimin e zbatimit të akteve apo të veprimeve procedurale, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi pezullimin e shqyrtimit të procedurës për miratimin e Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave e të përbërjes së tij deri në marrjen e vendimit nga kjo Gjykatë.

Gjithashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi që shqyrtimi i kësaj kërkesë të bëhet në seancë plenare vetëm mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, procedurë kjo e parashikuar dhe e lejuar nga neni 71 pika 5 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin thuhet: “Shqyrtimi i kërkesave të tilla mund të bëhet në seancë plenare edhe mbi shqyrtimin e dokumenteve”.

Neni 96 i Kushtetutës, në pamje të parë, krijon përshtypjen sikur ka të bëjë ekskluzivisht me Kryeministrin dhe se mosmiratimi i tij, si subjekt i veçantë nga Kuvendi, shkakton krizë qeveritare apo parlamentare. T’i japësh një kuptim të tillë dispozitës kushtetuese do të thotë të pranosh se mosmiratimi nga Kuvendi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave, sipas neni 97 të Kushtetutës, nuk sjell asnjë pasojë juridike kushtetuese, dhe se besimin politik Kuvendi ia jep Kryeministrit, thjesht për cilësitë e tij personale dhe jo për alternativën dhe për programin që propozon apo për përbërjen e ekipit që do të përmbushë këtë program. Natyrisht, një kuptim i tillë i neni 96 të Kushtetutës e ka bazën tek interpretimi jo i saktë që i bëhet kësaj dispozite.

Për interpretimin e saktë dhe përfundimtar të neneve 96 e 97 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se përmbajtja e këtyre dispozitave duhet parë në kontekstin e të gjithë neneve që parashikohen në Pjesën e Pestë të Kushtetutës, si dhe të dispozitave të tjera të saj, të analizuar dhe të vlerësuara këto edhe mbi bazën e koncepteve doktrinare të së drejtës kushtetuese shqiptare dhe asaj të huaj.

Në të njëjtën kohë, për të interpretuar drejt dispozitat e përmendura më lart, nuk mund të mos mbahen parasysh edhe çështje të tjera me rëndësi të veçantë, siç janë pozicioni i ekzekutivit në një Republikë Parlamentare, roli i Kryeministrit dhe i Këshillit të Ministrave e të raporteve midis tyre, rolin e veçantë të Kuvendit për formimin e organeve sidomos të Kryeministrit e të Këshillit të Ministrave, pa mënjanuar natyrisht në këtë proces interpretimin, analizën e këtyre dispozitave jo vetëm në aspektin gramatikor, por në të gjithë aspektet që bëjnë të mundur një shpjegim korrekt e të saktë të përmbajtjes së tyre.

Kushtetuta, në dallim nga Dispozitat Kryesore Kushtetuese, ka sjellë ndryshime në lidhje me pushtetin ekzekutiv për të siguruar stabilitet në qeverisje nëpërmjet mënjanimit të krizave qeveritare dhe të kabineteve qeveritare pa përgjegjësi politike. Kryeministri është pika qendrore e ekzekutivit nga pikëpamja e përgjegjësisë politike kundrejt Kuvendit. Nisur nga ky këndvështrim, Kushtetuta parashikon procedura të përpikta e të shpejta për emërimin e miratimin e Kryeministrit e të Këshillit të Ministrave, duke u kushtëzuar kjo me shpërndarjen e Kuvendit në rast mosmiratimi. Për Kuvendin që ushtron detyra të rëndësishme për formimin dhe kontrollin e Këshillit të Ministrave, rëndësi primare merr programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave. Prandaj, në kuptim të neneve 96 e 97 të Kushtetutës, Kuvendi i jep votëbesimin Këshillit të Ministrave jo vetëm për shkak të cilësive të Kryeministrit, por, në radhë të parë, nga programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave, të cilin ai do kryesojë e përfaqësojë. Kështu që, marrja në shqyrtim dhe miratimi i Kryeministrit siç përmend neni 96 i Kushtetutës, nuk mund të kuptohen të ndarë nga programi politik i Këshillit të Ministrave dhe nga përbërja e tij. Ky argument del edhe nga përmbajtja e neneve 96 e 97 të Kushtetutës dhe të çon në konkluzionin se miratimi i Kryeministrit nuk është i ndarë në kohë me miratimin e programit dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave.

Nenet 96, 97, 104 e 105 të Kushtetutës përcaktojnë që Presidenti emëron Kryeministrin. Kjo do të thotë, që, në çdo rast, përfshirë edhe rastin e zgjedhjes së Kryeministrit nga Kuvendi (neni 96 paragrafi 3, neni 104 e 105 paragrafi 1 i Kushtetutës), emërimi i Kryeministrit është kompetencë e Presidentit. Mirëpo, Kryeministri i emëruar nga Presidenti ende nuk fiton si organ cilësitë juridike për të marrë përsipër përgjegjësi politike për veprimtarinë e tij dhe të Këshillit të Ministrave derisa nuk është miratuar nga Kuvendi.

Në dallim nga ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Kushtetuta, edhe pse e koncepton Kryeministrin si subjekt të veçantë që mbart të drejta e detyrime të rëndësishme kushtetuese e ligjore, përcakton përgjegjësinë e tij politike të lidhur ngushtë me veprimtarinë e Këshillit të Ministrave. Është kjo arsyeja që mocioni i mosbesimit, sipas nenit 105/1 të Kushtetutës, paraqitet vetëm ndaj Kryeministrit edhe pse objekt mund të jetë vetëm veprimtaria e tij si subjekt i Këshillit të Ministrave që ai drejton, pa përjashtuar edhe atë të ministrave të veçantë. Për pasojë, pranimi i mocionit shkakton shkarkimin e Këshillit të Ministrave në tërësi.

Neni 97 i Kushtetutës parashikon detyrimin e Kryeministrit të emëruar nga Presidenti që brenda 10 ditëve të paraqesë për miratim programin politik të Këshillit të Ministrave, së bashku me përbërjen e tij. Qëllimi i kësaj dispozite është që Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave që ky do ta drejtojë, t’ia nënshtrojnë kontrollit parlamentar programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, përfshirë edhe Kryeministrin (neni 95/1 të Kushtetutës), si kusht për dhënien e besimit politik. Por, ky detyrim i parashikuar në nenin 97 të Kushtetutës, kurrsesi, nuk duhet kuptuar si një veprim që realizohet pas miratimit të Kryeministrit të emëruar sipas nenit 96 të Kushtetutës. Nëse Kushtetuta do të kishte këtë qëllim, nuk do të shprehej në nenin 97 të saj se “Kryeministri i emëruar sipas nenit 96...”, por do të përdorte termin “Kryeministri i miratuar sipas nenit 96...”, që janë dy gjëra krejt të ndryshme. Duke pasur cilësinë e një Kryeministri të emëruar por të pamiratuar, ai i drejtohet Kuvendit me qëllim përmbushjen e detyrimit kushtetues që buron nga neni 97 i Kushtetutës. Ky kuptim, që rezulton nga përmbajtja e neneve 96 e 97 të Kushtetutës të çon në konkluzionin se Kryeministri i emëruar por i pamiratuar i paraqitet Kuvendit për miratim, së bashku me programin politik, dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave.

Nisur nga argumentet e parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin përfundimtar se Kryeministri i emëruar duhet të paraqitet në Kuvend për t’u miratuar njëherësh me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 124, 132 e 134/1-c të Kushtetutës, si dhe neneve 45, 71, 72 e 79 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Interpretimin e neneve 96 e 97 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në këtë mënyrë:

- Kryeministri i emëruar nga Presidenti i Republikës miratohet në Kuvend njëherësh me programin politik dhe me përbërjen e Këshillit të Ministrave.

- Hiqet masa e pezullimit të procedurave të shqyrtimit për miratim nga Kuvendi të Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij, e vendosur me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese datë 20.2.2002.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.

Shënim: Botim i plotë i vendimit nr.28, datë 21.2.2002 i Gjykatës Kushtetuese, botuar në Fletoren nr.5, mars 2002.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 4.4.2002
Doli nga shtypi më 5.4.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë